



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 12

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

		faqe
Vendim i KM nr. 74, datë 6.2.2003	Për miratimin e statutit të agjencisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	335
Vendim i KM Nr. 75, datë 6.2.2003	Për miratimin e pagesave që kryhen në entin rregullator të telekomunikacioneve	342
Vendim i KM Nr. 76, datë 6.2.2003	Për nivelet e pagave të anëtarëve të këshillit drejtues të entit rregullator të telekomunikacioneve	346
Vendim i KM Nr.77, datë 6.2.2003	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	347
Vendim i KM Nr. 78, datë 6.2.2003	Për miratimin e stemës, të uniformës dhe të normativave të veshmbathjes për policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	356
Vendim i KM Nr.79, datë 6.2.2003	Për pagat e punonjësve të institutit të trajnimit të administratës publike	359
Vendim i KM Nr. 81, datë 6.2.2003	Për shitje trualli, kishës ortodokse autoqefale të shqipërisë	360

Vendim i KM Nr. 84, datë 13.2.2003	Për administrimin dhe mbulimin e shërbimeve nga personeli mjekësor, i përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore	362
Vendim i KM Nr. 85, datë 13.2.2003	Për lidhjen e kontratave, ndërmjet institutit të sigurimeve të kujdesit shëndetësor dhe farmacive e depove të barnave	363
Vendim i KM Nr. 86, datë 13.2.2003	Për librezën e shëndetit	364
Vendim i KM Nr. 87, datë 13.2.2003	Për identifikimin dhe detyrimet e personave, që marrin shërbim shëndetësor në Republikën e Shqipërisë	365

V E N D I M
Nr. 74, datë 6.2.2003

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE
TË MESME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit të Agjencisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROJEKT STATUTI
I AGJENCISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Vlera ligjore e statutit

Statuti është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë e kësaj Agjencie, krijimi i së cilës është parashikuar nga ligji nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”.

Neni 2
Statusi juridik i Agjencisë

Agjencia është person juridik publik dhe nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Nëse ndonjë veprimtari e saj mund të gjenerojë të ardhura, këto duhet të kontabilizohen në zërat përkatëse të fondeve të Agjencisë dhe do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar Agjencia.

Neni 3

Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë, në adresën bulevardi Zhan d’Ark, pallatet e Lanës. Agjencia ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Agjencia mund të krijojë strukturat përkatëse lokale.

Neni 4
Stema dhe vula

Stema e Agjencisë shpreh thelbin e aktivitetit të saj, që është mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe duhet të figurojë në të gjithë materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të Agjencisë.

Përmbajtja e vulës së Agjencisë është: Republika e Shqipërisë, Agjencia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË

Neni 5
Ligjshmëria e veprimtarisë

Agjencia vepron në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 9857, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, zbaton politikat dhe strategjitë, zhvillon dhe koordinon programe dhe projekte në mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 6
Objekti

Agjencia do të ketë objekt të veprimtarisë:

- Zbatimin e politikave dhe strategjive, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, në drejtim të mbështetjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Zhvillimin dhe koordinimin e programeve dhe projekteve, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
- Dhënien e rekomandimeve, propozimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjet dhe rregullat, që kanë efekt në zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve dhe gjithashtu në programet dhe projektet që lidhen me të.
- Mbajtjen e lidhjeve të ngushta me Këshillin e Ministrave nëpërmjet anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
- Mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me të gjitha ministratë e linjës, organizmat shtetërore, institucionet financiare, dhomat e tregtisë dhe industrisë, agjencitë e zhvillimit të biznesit, shoqatat e biznesit dhe të sipërmarrësve, organizata të tjera, me qëllim që të ndihmojë koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe mbështetjen e programeve brenda dhe jashtë vendit.
- Koordinimin e programeve që lidhen me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për zonat industriale, inkubatorët e biznesit, programet e trajnimit, si dhe hartimin dhe zhvillimin e programeve kombëtare në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri.
- Propozimin dhe hartimin e planeve për një koordinim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet organizatave të ndryshme ekzistuese, të vendit apo të huaja, si dhe strukturave aktuale të përfshira në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri.
- Nxitjen dhe mbështetjen e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet aktorëve kryesorë në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe komunitetit të biznesit në tërësi.
- Identifikimin e problemeve dhe dhënien e zgjidhjeve të mundshme të tyre në lidhje me kuadrin rregullator, politikat ekonomike, financiare dhe fiskale në drejtim të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Vlerësimin e lehtësirave në kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe formulimin e propozimeve në drejtim të përmirësimit të sistemit të financimit të këtyre ndërmarrjeve.
- Krijimin e mundësive të reja për kërkime tregu për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Kryerjen e veprimtarive studimore në përputhje me funksionet e saj, duke përfshirë studime fizibiliteti, studime tregu, anketime, konsulencë në praktikën tregtare, të menaxhimit dhe të veprimtarive nxitëse.
- Mbledhjen, përpunimin, ndërtimin dhe zhvillimin e një sistemi informacioni për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Republikën e Shqipërisë, si dhe shpërndarjen dhe shkëmbimin e tij me rrjetin e subjekteve të interesuara.
- Dhënien e ndihmesës në promovimin e kulturës së biznesit në të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit.

BURIMET E FINANCIMIT

Neni 7
Burimet bazë të financimit

Burimi kryesor i financimit të Agjencisë është Buxheti i Shtetit.
Agjencia mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm, si dhe të ardhura nga shërbimet dhe projektet e realizuara prej saj.

Neni 8 **Përdorimi i fondeve**

Në zbatim të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, Agjencia është e autorizuar të veprojë si administratore e fondeve të siguruar nga Buxheti i Shtetit dhe nga donatorë të ndryshëm, vendas apo të huaj, për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Agjencia gëzon të drejtën e depozitimit dhe përdorimit të mjeteve të saj financiare në bazë të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Agjencia nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie tjetër, jashtë objektivave dhe programit të përcaktuar në statutin e saj.

Fondet financiare të saj nuk mund të përdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë për qëllime të tjera.

Financimi, që Agjencia merr nga burimet e ndryshme, përdoret vetëm për kryerjen e veprimtarive sipas objektit të saj.

Agjencia krijon dhe menaxhon fondet e mëposhtme:

- fondin themelor,
- fondin e mjeteve të xhiros,
- fondin rezervë në lekë,
- fondin rezervë në valutë,
- fonde të tjera sipas vendimeve të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 9 **Qëndrimi ndaj donacioneve**

Donacionet pranohen ose kundërshtohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë përmban edhe arsyet e refuzimit.

Donatorët e huaj ose vendas, të cilët kontribuojnë me fonde financiare, me një vlerë që përbën më shumë se 50% të fondeve vjetore të Buxhetit të Shtetit për Agjencinë, kanë të drejtë të caktojnë një këshilltar pranë Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë. Drejtori Ekzekutiv duhet të konsultohet me këshilltarin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të dhëna nga donatori.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË

Neni 10 **Organet drejtuese**

Organet e Agjencisë janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës
2. Drejtori Ekzekutiv

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 11 **Përbërja**

Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, si më poshtë vijon:

Zëvendësministri i EkonomisëKryetar

Zëvendësministri i Financave Anëtar
Zëvendësministri i Punës dhe Çështjeve Sociale Anëtar
Një përfaqësues i Qendrës Kombëtare të ARZH-ve Anëtar
Një përfaqësues i Shoqatës së Bankierëve të Shqipërisë Anëtar
Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që përfaqësojnë komunitetin e biznesit emërohen nga Ministri i Ekonomisë me propozim të shoqatave të biznesit, për një periudhë dy-vjeçare me sistem rotacioni. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë të Ekonomisë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës informon Ministrin e Ekonomisë për probleme të rëndësishme, lidhur me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 12

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon me:

- a) mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 11 të statutit të Agjencisë;
- b) jep dorëheqjen;
- c) shkarkohet nga detyra për veprime ose mosveprime, që dëmtojnë rëndë interesat e Agjencisë;

d) mungon pa arsye në 3 mbledhje dhe me arsye në 4 mbledhje të një viti.

Kërkesa për dorëheqje i bëhet me shkrim Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili duhet ta miratojë atë brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

- miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të Agjencisë;
- miraton strukturën organizative dhe harton buxhetin e Agjencisë, të cilin ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave nëpërmjet Ministrisë të Ekonomisë;
- harton projektin e parë të statutit të Agjencisë dhe i propozon ndryshimet e tij në të ardhmen Këshillit të Ministrave nëpërmjet Ministrisë të Ekonomisë;
- i propozon Ministrisë të Ekonomisë, ligje e akte nënligjore që rregullojnë dhe nxisin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- emëron dhe liron Drejtorin Ekzekutiv;
- miraton bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- miraton programin e punës për vitin financiar, të paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv;
- miraton marrëveshjet dhe pjesëmarrjen e Agjencisë në projekte të ndryshme bashkëpunimi;
- mbikëqyr veprimtarinë e Agjencisë në përputhje me rregulloret e brendshme të saj.

Neni 14

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës mbledhet në mënyrë periodike, jo më pak se 4 herë në vit. Atë e thërret Kryetari i Këshillit. Anëtarët lajmërohen me shkrim nga Drejtori Ekzekutiv, 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Në njoftimin e mbledhjes jepen data, ora, vendi i zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendi i ditës. Kur ka nevojë, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet që parashikohen të merren në mbledhje.

Në raste të veçanta mbledhja e tij thirret nga Drejtori Ekzekutiv ose nga të paktën tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës bashkërisht.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë së tij, nga anëtar i moshuar, që merr pjesë në mbledhje.

Neni 15
Vlefshmëria e mbledhjeve

Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme, pa qenë të pranishëm të paktën një anëtar, më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve. Kur ky numër nuk arrihet mbledhja shtyhet dhe mbahet brenda 24 orëve.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur. Votimi mund të kryhet edhe me anë shkëmbimi të dokumentacionit të shkruar, sipas rregullave të konsultimit me shkrim. Në rast rezultati të barabartë votash, vota e Kryetarit është përcaktuese.

Neni 16
Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë

Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, Kryetari fton këshilltarë ose/dhe ekspertë të jashtëm, kur këtë e kërkojnë rrethanat.

Drejtori Ekzekutiv, këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 17
Konflikti i interesave

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës, kur çështje të rendit të ditës dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës lidhen direkt me interesat e tyre të biznesit. Në këto raste, ata nuk marrin pjesë në diskutimet dhe as në votimin e vendimeve që merren për çështjet në fjalë.

Neni 18
Shpërblimi

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit.

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është i përmuajshëm, por kushtëzohet nga pjesëmarrja në çdo mbledhje.

Për Kryetarin e Këshillit masa e shpërblimit do të jetë 20% e pagës mujore të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.

Për anëtarët e Këshillit masa e shpërblimit do të jetë 10% e pagës mujore të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.

DREJTORI EKZEKUTIV I AGJENCISË

Neni 19
Mandati i Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës për një afat tre-vjeçar, me të drejtë zgjatjeje të këtij afati edhe për tre vjet të tjerë. Përzgjedhja e tij bëhet me konkurrim, që njoftohet publikisht në organet e shtypit, nga të paktën tre konkurreues.

Neni 20
Tagrat e përfaqësimit

Agjencia, në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe në mungesë të tij nga një punonjës i Agjencisë, i caktuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 21
Kompetencat

Drejtori Ekzekutiv ka këto të drejta dhe detyra:

- Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës.
- Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Agjencisë dhe ia paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës.
- Para fillimit të çdo veprimtarie, në funksion të përmbushjes së programit të punës, i paraqet Këshillit Mbikëqyrës buxhetin dhe programin për realizimin e tij.
- Harton dhe i paraqet për miratim Këshillit bilancin e Agjencisë.
- Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i Agjencisë në përputhje me objektivat, qëllimin e funksionimit të Agjencisë.
- Raporton të paktën 4 herë në vit para Këshillit Mbikëqyrës për veprimtarinë e Agjencisë.
- Harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, duke përdorur metodën e konkurrencës të shpallur publikisht për çdo vend pune.
- Bashkërendon punën me Këshillin Mbikëqyrës, për të zhvilluar dhe administruar me sukses strategjinë e qeverisë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e Agjencisë, që i shërbejnë përmirësimit të klimës së biznesit në Shqipëri.
- Bashkëpunon me donatorë vendas dhe të huaj për sigurimin e fondeve të Agjencisë.
- Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike.
- Garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese të bëra nga Agjencia dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve publike e private të interesuara.
- Koordinon programet dhe projektet për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri dhe bashkëpunon me institucionet dhe organizatat përkatëse qeveritare apo joqeveritare, për të gjitha llojet e shërbimeve ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe në mënyrë më të veçantë për organizimin e seminareve dhe kurseve të trajnimit.
- Mbështet aktivisht shërbimet e këshillimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe grumbullimin dhe shpërndarjen e informacioneve në lidhje me këto ndërmarrje.
- Analizon dhe vlerëson studimet dhe anketimet lidhur me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe raporton vazhdimisht mbi situatën e tyre në rajone të ndryshme të vendit, si dhe mbi krijimin e kushteve për zhvillimin e biznesit të vogël në Shqipëri.

Neni 22
Mbarimi i mandatit

Drejtori Ekzekutiv lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) mbaron mandati i emërimit dhe ai nuk rrimërohet;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) emërohet në një detyrë tjetër, të papajtueshme me të Drejtorit Ekzekutiv.

Drejtori Ekzekutiv lirohet nga detyra edhe para mbarimit të mandatit kur:

- a) konstatohet se nga drejtimi i tij i dobët Agjencia mbingarkohet me borxhe;
- b) shpallet fajtor për vepra penale;
- c) vepron në kundërshtim me programin dhe objektivat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 23
Struktura dhe organika e Agjencisë

Struktura, organika dhe niveli i pagave të Agjencisë përcaktohen e miratohen me vendim të

Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 24
Rregullat e punësimit

Kriteret e marrjes në punë të personelit të Agjencisë, si dhe përshkrimi i vendeve të punës, përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe lidhja e kontratave të punës bëhet nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 25
Viti financiar

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Për çdo vit financiar përpilohet bilanci ekonomiko-financiar, i cili vlerësohet konform dispozitave ligjore në fuqi. Brenda datës 30 prill të çdo viti, Drejtori Ekzekutiv i paraqet Këshillit Mbikëqyrës bilancin e vitit financiar paraardhës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 26
Kontrolli

Për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të Agjencisë, Këshilli Mbikëqyrës cakton ekspertë ose ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjeve në fuqi.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27
Të tjera

Çështjet specifike të veprimtarisë së Agjencisë, të cilat nuk parashikohen në këtë statut do të rregullohen në rregulloren e brendshme të Agjencisë.

V E N D I M
Nr. 75, datë 6.2.2003

**PËR MIRATIMIN E PAGESAVE QË KRYHEN NË ENTIN RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91 të ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesave që kryhen në Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Vendimi nr. 71, datë 15.2.2001 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e pagesave që kryhen pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PAGESAT QË KRYHEN PRANË ERT-SË

I. Përpunimi i kërkesave për licencim:

Tipi i licencës	Pagesa	Periodiciteti i pagesës
Licencë individuale e klasit të II-të me përjashtim të rrjeteve të pavarur të radiokomunikimit.	3000 lekë	Vetëm një herë
Licencë e përgjithshme	1000 lekë	Vetëm një herë

II. Dhënie e licencës

Kjo pagesë është e njëjtë me pagesën vjetore dhe kryhet me marrjen e licencës

III. Pagesat vjetore të licencave

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Operator publik i telekomunikacioneve		
Licencë		
Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm.	7 000 000 lekë	çdo vit
Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor.	7 000 000 lekë	çdo vit
Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm për zonat rurale	20 000 lekë/komunë	çdo vit
Shërbim internet		
Licencë		
Shërbim internet	25 000 lekë Pop	çdo vit
	75 000 lekë ISP lokale	çdo vit
	150 000 lekë ISP rajonale	çdo vit
	200 000 lekë ISP kombëtare	çdo vit
	2000 000 lekë operator kackbone	çdo vit
Rregjistrim domaini	75 USD	çdo 2 vjet
Shërbim publik radiokomunikimi i lëvizshëm		
Licencë		
Shërbim radio i kërkimit të personit (Paging)	30 000 lekë për sistem lokal	çdo vit
	75 000 lekë për sistem rajonal	çdo vit
	150 000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit
Sisteme të telefonisë së lëvizshme GSM	100 000 lekë për çdo kanal 200 Khz ekskluziv	çdo vit
Shërbim telefonik i lëvizshëm (GMPCS)	2 000 USD	çdo vit
Shërbim aeronautik		
Licencë		
Sistem tokësor radiokomunikimi	15 000 lekë	çdo vit
Sistem radiokomunikimi në avion	10 000 lekë	çdo vit
Shërbim detar		
Licencë		
Stacion bregdetar	20 000 lekë	çdo vit
Sistem radiokomunikimi në anije	7 500 lekë	çdo vit
Shërbime portuale	5 000 lekë	çdo vit
Shenjë thirrje anijeje	2 500 lekë	një herë

Kod MMSI	2 500 lekë	një herë
Shërbim satelitor		
Licencë Stacion tokësor fiks Sistem satelitor VSAT Terminal satelitor i lëvizshëm Stacion tokësor i lëvizshëm (SNG)	150 000 lekë 15 000 lekë për çdo terminal VSAT 5 000 lekë 1 000 USD për licencë 1 (një) javore 500 USD për çdo javë vijuese 2 000 USD për licencë 1 (një) mujore 5 000 USD për licencë 3 (tre) mujore	çdo vit çdo vit çdo vit
Shërbim transmetimi të dhënash		
Licencë Transmetim të dhënash	75 000 lekë për sistem lokal 150 000 lekë për sistem rajonal 200 000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit çdo vit çdo vit
Shërbim radioamator		
Certifikatë radioamatori Leje transmetimi	500 lekë 200 lekë -për radioamatorët e huaj: 500 lekë – leje transmetimi 1 mujore 1 000 lekë – leje transmetimi 3 mujore 2 000 lekë – leje transmetimi 6 mujore	vetëm 1 herë çdo 5 vjet
Shërbim fiks (radio – rele)		
Licencë Sistem një drejtimesh (pikë-pikë)	25 000 lekë për çdo link	çdo vit
Sistem dy drejtimesh (pikë-pikë)	75 000 lekë për çdo link	çdo vit
Sistem dy drejtimesh (pikë-shumë pika).	50 000 lekë për çdo sistem	çdo vit
Shërbim i pavarur radiokomunikimi i lëvizshëm		
Licencë Sistem i lëvizshëm tokësor Sistem trunk Sistem tetra	5 000 lekë për çdo sistem simpleks 15 000 lekë për çdo sistem gjysëm dupleks 10 000 lekë për sistem rajonal 25 000 lekë për sistem kombëtar 30 000 lekë për sistem rajonal 75 000 lekë për sistem kombëtar - sistemi simpleks përfshin një numër të pakufizuar stacione bazë, stacione makine dhe radio-portabël - sistemi gjysëm dupleks përfshin 1 (një) përsëritës dhe numër të pakufizuar stacione bazë, stacione makine dhe radio- portabël	çdo vit çdo vit çdo vit çdo vit çdo vit çdo vit
Shërbime të tjera		
Licencë Sistem radioalarmi Sistem radiokomunikimi në HF Ofrim shërbimesh Telekomunikacioni	15 000 lekë 15 000 lekë 10 000 lekë për një rreth/qytet/fshat 40 000 lekë për një rajon 60 000 lekë për gjithë territorin	çdo vit çdo vit çdo vit çdo vit çdo vit

Instalim, programim, projektim, assemblim pajisje fundore e sisteme telekomunikacioni		
Licencë		
Instalim, programim, assemblim	7 500 lekë	çdo vit
Projektim, konsulencë, supervizim	5 000 lekë	çdo vit

IV. Pagesat për numeracion

Këto pagesa kryhen vetëm 1 (një) herë si më poshtë:

a) Kod i shkurtër:

- Formatet “kod aksesit shërbimi + numër identifikues i subjektit” dhe “kod aksesit shërbimi + numër përdoruesi” dhe të tjerë analogë me të

25 000 lekë

- Formatet “kod aksesit shërbimi+numër identifikues i subjektit” kur ndryshon vetëm “kodi i aksesit të shërbimit” ose pjesa analoge me të

10 000 lekë

- Formatet “kod aksesit shërbimi+numër përdoruesi” kur ndryshon vetëm

“numri i përdoruesit”ose pjesa analoge me të 10 000 lekë

- b) Numër i shkurtër në serinë “1” të numrave të përdoruesit (shërbime për publikun), përjashtuar shërbimet e urgjencës dhe ato shërbime që ofrohen tërësisht pa pagesë për publikun:

- Formatet bazë 3 shifror 50 000 lekë

c) Prefiks për zgjedhjen e mbartësit:

Formatet bazë 2 shifror në vijim të kodit të aksesit të mbartësit

50 000 lekë

Formatet i zgjeruar mbi formatin bazë

25 000 lekë

d) Bllok numrash për përdoruesit:

- Bllok mijësh 2 000 lekë

- Bllok dhjetëmijësh 5000 lekë

V. Miratim tipi

Kjo pagesë aplikohet vetëm 1 (një) herë si më poshtë:

Certifikatë Miratim Tipi për subjekte tregtuese vendase 3 000 lekë

Certifikatë Miratim Tipi për subjekte jotregtuese vendase 100 lekë

Certifikatë Miratim Tipi për subjekte të huaja 100 euro

V E N D I M

Nr. 76, datë 6.2.2003

PËR NIVELET E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të nenit 85 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Niveli i pagave të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të jetë si më poshtë:

a) Paga e Kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të përcaktohet, sipas kategorisë I-a, të klasës I, të lidhjeve nr.I dhe nr.II, të vendimit nr.711, datë

27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

b) Paga e anëtarit të Këshillit Drejtues të njehsohet me pagën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas kategorisë II-a të klasës II të lidhjeve nr.1 dhe nr.2, të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

2. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagesat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në klasifikimin A12, emërtimi “Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”, shfuqizohet.

b) Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” shfuqizohen këto emërtime:

- Në klasifikimin A12 “Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”;

- Në klasifikimin B2 “Anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”.

3. Në vendimin nr.390, datë 24.6.1998 të Këshillit të Ministrave, pikat 2a, 2b dhe 2c shfuqizohen.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

5. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.77, datë 6.2.2003

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË SË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura e PMNZSH-së të jetë sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Organika e PMNZSH-së të jetë sipas skemës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Numri limit i punonjësve në organikën e PMNZSH-së të jetë 743 veta.
4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe, prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Shpjegues:

STRUKTURA ORGANIKE E PMNZSH

Skema nr.1



Shigjeta pa nderprerje: vartesiadministrative

Shigjeta me nderprerje: vartesi metodike

Lidhja 2

LIMITI ORGANIK I PMNZSH DREJTORIA E PMNZSH

Drejtor i Drejtorisë së PMNZSH-së oficer1
Shef sek. i logjistikës e koordinimit stac.zjarrëf oficer1
Specialist oficer2
Spektori i inspektimit & parandalimit, (Inspektor) oficer2
Shef i qendrës kombëtare të trajnimit oficer1
Instruktor për ndërhyrjen, pajisjet dhe shpëtimin oficer1
Specialist (ekonomist) oficer1
Mekanik polic1
Shofer polic1
Sekretarë+magazinerë polic1

I. PREFEKTURA E QARKUT TIRANË

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkut, oficer1
Stacioni PMNZSH-së, Tiranë 1 (rajoni “21 Dhjetori”)
2. Shefi i PMNZSH-së rajonit nr.1+ Kom. Stacioni oficer1
3. Zv/kom. stacioni+kujdestar (ekonomist i mesëm) polic1
4. Inspektor profilaksie oficer 1+ polic 12

5. Mekanik-shofer polic	1	
6. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
7. Punonjes informacioni polic	4	
8. Shofere zjarrfikës, shpëtues polic	8	
10. Policë zjarrfikës, shpëtues polic	12	
11. Pastruese civil	1	
funksione	34	
Stacioni PMNZSH-së, Tiranë 2 (rajoni “Kombinat”)		
1. Shef i PMNZSH-së, rajonit + Komand. stacionioficer	1	
2. Inspektor profilaksie polic	1	
3. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
4. Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	4	
5. Policë zjarrfikës, shpëtues polic	8	
	funksione	14
Stacioni PMNZSH-së, Tiranë 3 (rajoni “Kinostudio”)		
1. Shef i PMNZSH-së rajonit + Komand. stac. oficer	1	
2. Inspektor profilaksie polic	1	
3. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
4. Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	4	
5. Policë zjarrfikës, shpëtues polic	4	
	funksione	18
Stacioni PMNZSH-së, Tirane 4 (rajoni “kthesa e Kamzës”)		
1. Shefi i PMNZSH-së rajonit + Komand. stacionioficer	1	
2. Inspektor profilaksie polic	1	
3. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	4	
Policë zjarrfikës, shpëtues polic	4	
	funksione	14
Stacioni i PMNZSH-së, Kavajë		
Shefi i PMNZSH-së, rrethit + Komand. stacionioficer	1	
Inspektor profilaksie polic	1	
Përgjegjës shërbimi 24 orësh polic	4	
Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	8	
Policë zjarrfikës, shpëtues polic	8	
funksione	22	
Totali	funksione	102

II. PREFEKTURA E QARKUT Durrës

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkut oficer	1	
Stacioni PMNZSH-së, Durrës 1		
2. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. stacionioficer	1	
3. Zv/kom. stacioni, kujdestar (ekonomist i mesëm) polic	1	
4. Inspektor profilaksie polic	2	
5. Shofer + mekanik polic	1	
6. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
7. Punonjes informacioni polic	4	
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	8	
9. Policë zjarrfikës, shpëtues polic	12	
	funksione	33
Stacioni i PMNZSH-së, Durrës 2 (rajoni “Plazh”)		
1. Shefi i PMNZSH-së rajonit + Komand. stacionioficer	1	
2. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic	4	
3. Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic	4	

4. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic4	funksione	13
Stacioni i PMNZSH-së, Krujë		
1. Shefi i PMNZSH-së Rrethit + Komand.stacionioficer1		
2. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4		
3. Shofere zjarrfikës, shpëtuespolic4		
4. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
	funksione	17

Totali funksione 63

III. PREFEKTURA E QARKUT, FIER

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit tëQarkutoficer1		
Stacioni PMNZSH-së, Fier 1		
2. Shefi i PMNZSH-së rrethit+ Komand. stacionioficer1		
3. Zv/kom.stacioni, kujdestar (ekonomist i mesëm)polic1		
4. Inspektor profilaksiepolic2		
5. Mekanik +shofer zjarrfikëspolic1		
6. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4		
7. Punonjës informacionipolic4		
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
9. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic 12		
	funksione	33
Stacioni i PMNZSH-së Fier 2 (rajoni “Azotik”)		
1. Komandant stacionipolic1		
2. Shofer zjarrfikëspolic4		
3. Polic zjarrfikespolic4		
	funksione	9
Stacioni PMNZSH-së, Fier 3 (rajoni Patos)		
Komandanti stacionitpolic1		
Shoferë zjarrfikëspolic4		
Police zjarrfikëspolic4		
	funksione	9
Stacioni PMNZSH-së, Ballsh		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit+ Komand.stac.oficer1		
2. Shoferë zjarrfikëspolic4		
3. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
	funksione	13
Stacioni i PMNZSH-së, Lushnjë		
Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stac.oficer1		
Përgjegjës shërbimi 24 orëshpolic4		
Shoferë zjarrfikëspolic8		
Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
	funksione	21
Totali funksione		85

IV. PREFEKTURA E QARKUT BERAT

1. Shefi i sektorit të PMNZSH Prefektit të Qarkutoficer1
- Stacioni i PMNZSH-së, Berat 1
2. Shefi i PMNZSH-së rrethit+Komand. stacionioficer1

3. Zv/kom.stacioni + kujdestar (ekonomist i mesëm)polic1	
4. Inspektor profilaksiepolice1	
5. Mekanik, shofer zjarrfikëspolic1	
6. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4	
7. Punonjës informacionipolic4	
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic8	
9. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8	
funksione	28
Stacioni i PMNZSH-së, Berat 2 (rajonit “Kombinat”)	
1. Komandant stacionipolic1	
2. Shofer zjarrfikëspolic4	
3. Polic zjarrfikëspolic4	
funksione	9
Stacioni i PMNZSH-së, Kuçovë	
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer1	
2. Përgjegjës shërbimipolic4	
3. Shoferë zjarrfikëspolic4	
4. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8	
funksione	17
Stacioni i PMNZSH-së, SKRAPAR	
Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer1	
Shoferë zjarrfikëspolic4	
Policë zjarrfikëspolic8	
funksione	13
Totali funksione	67

V. PREFEKTURA E QARKUT, VLORË

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkutoficer1	
Stacioni PMNZSH-së, Vlorë 1	
2. Shefi i PMNZSH-së rrethit +Komand stacionioficer1	
3. Zv/kom.stacioni+ kujdestar, (ekonomist i mesëm)polic1	
4. Inspektor profilaksiepolice1	
5. Mekanik-shofer zjarrfikëspolic1	
6. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4	
7. Punonjës informacionipolic4	
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic8	
9. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic	8
funksione	30
1. Shefi i PMNZSH-së, Nënprefektit, rrethit Delvinëoficer1	
2. Polic, shofer zjarrfikës.polic4	
Stacioni i PMNZSH-së, Sarandë	
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit+Komand.stacioni oficer1	
2. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4	
3. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic4	
4. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8	
funksione	17
Totali funksione	51

VI. PREFEKTURA E QARKUT, GJIROKASTËR

1. Shefi i sektorit të PMNZSH Prefektit të Qarkutoficer1

Stacioni PMNZSH-së, Gjirokastrë		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit+Komand. stacionioficer	1	
2. Zv/kom.stacioni +kujdestar (ekonomist i mesëm)polic	1	
3. Inspektor profilaksie	1	
4. Përgjegjës shërbimi 24-orësh	4	
5. Shoferë zjarrfikës, shpëtues	8	
6. Policë zjarrfikës, shpëtues	8	
		funksione 23
Stacioni i PMNZSH-së, Përmet		
Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. stacionioficer	1	
Shofer zjarrfikës	4	
Police zjarrfikës	8	
		funksione 13
Stacioni i PMNZSH-së, Tepelenë		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer	1	
2. Shoferë zjarrfikës	4	
3. Policë zjarrfikës	8	
		funksione 13
Totali	funksione	50

VII. PREFEKTURA E QARKUT, KORÇË

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkutoficer		
Stacioni PMNZSH-së, Korçë		
2. Shefi i PMNZSH-së, rrethit+Komand.stacionioficer	1	
3. Zv/kom.stacioni+kujdestar (ekonomist i mesëm)polic	1	
4. Inspektor profilaksie	2	
5. Mekanik-shofer zjarrfikës	1	
6. Përgjegjës shërbimi 24-orësh	4	
7. Punonjës informacioni	4	
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtues	8	
9. Policë zjarrfikës, shpëtues	8	
		funksione 29
1. Shefi i PMNZSH-së, Nënprefektit, rrethit Devoll.oficer		
2. Polic, shofer zjarrfikës.polic		
Stacioni i PMNZSH-së, Ersekë		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacioni	oficer	1
2. Shoferë zjarrfikës	4	
3. Policë zjarrfikës	8	
		funksione 13
Stacioni i PMNZSH-së, Pogradec		
Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer	1	
Shoferë zjarrfikës	8	
Policë zjarrfikës	8	
		funksione 17
Totali	funksione	63

VIII. PREFEKTURA E QARKUT, ELBASAN

1. Shefi i sektorit të PMNZSH Prefektit të Qarkutoficer
- Stacioni PMNZSH Elbasan
2. Shefi i PMNZSH-së, rrethit + Komand. stacionioficer

3. Inspektor profilaksie polic 2
 4. Zv/kom.stacioni, kujdestar (ekonomist i mesëm) polic 1
 5. Mekanik+shofer zjarrfikës polic 1
 6. Përgjegjës shërbimi 24-orësh polic 4
 7. Punonjës informacioni polic 4
 8. Shoferë zjarrfikës, shpëtues polic 8
 9. Policë zjarrfikës, shpëtues polic 12
 funksione 34

1. Shefi i PMNZSH-së, nënprefektit, rrethit, Peqin. oficer 1
 2. Polic, shofer zjarrfikës polic 4
 Stacioni i PMNZSH-së, Gramsh
 1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. Stacioni oficer 1
 2. Shoferë zjarrfikës polic 4
 3. Policë zjarrfikës polic 8
 funksione 13

Stacioni i PMNZSH-së, Librazhd
 1. Shefi i PMNZSH-së rrethit oficer 1
 2. Shoferë zjarrfikës polic 4
 3. Policë zjarrfikës polic 8
 funksione 13

Totali funksione 64

IX. PREFEKTURA E QARKUT, LEZHË

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkut oficer 1
 Stacioni PMNZSH-së, LEZHË
 2. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. stacioni oficer 1
 3. Inspektor profilaksie polic 1
 4. Përgjegjës shërbimi 24 orësh polic 4
 5. Policë zjarrfikës, shofer, shpëtues polic 18
 funksione 24

Stacioni i PMNZSH-së, Mirditë
 1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. stacioni oficer 1
 2. Përgjegjës shërbimi 24- orësh polic 4
 3. Shoferë zjarrfikës polic 4
 4. Policë zjarrfikës polic 4
 funksione 13

Stacioni i PMNZSH-së, Laç
 1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand. stacioni oficer 1
 2. Përgjegjës shërbimi 24 orësh polic 4
 3. Shoferë zjarrfikës polic 4
 4. Policë zjarrfikës polic 4
 funksione 13

Totali funksione 50

X. PREFEKTURA E QARKUT, SHKODËR

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkut oficer 1
 Stacioni PMNZSH-së, Shkodër

2. Shefi i PMNZSH-së, rrethit + Komand.stacionioficer1		
3. Zv.komand+kujdestar-magaznier(ekonomist)polic1		
4. Inspektor profilaksiepolic2		
5. Mekanik +shoferë zjarrfiksepolic1		
6. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4		
7. Punonjës informacionipolic4		
8. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
9. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic	12	
funksione	34	
Stacioni i PMNZSH-së, Koplik		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer1		
2. Përgjegjës shërbimipolic4		
3. Shoferë zjarrfikëspolic4		
4. Polic zjarrfikëspolic4		
	funksione	13
Stacioni i PMNZSH-së, Pukë		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer1		
2. Përgjegjës shërbimipolic4		
3. Shoferë zjarrfikëspolic4		
4. Policë zjarrfikëspolic4		
	funksione	13
Totalifunksione	60	

XI. PREFEKTURA E QARKUT, KUKËS

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkutoficer1		
Stacioni PMNZSH-së, Kukës		
2. Komand.stacioni+ kujdestarpolic1		
3. Inspektor profilaksiepolic1		
4. Përgjegjës shërbimi 24-orëshpolic4		
5. Shoferë zjarrfikës, shpëtuespolic4		
6. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
funksione	18	
Shefi i PMNZSH-së, Nënprefektit, rrethit, Hasoficer1		
Stacioni i PMNZSH-së, B.Curri		
1. Shefi i PMNZSH-së rrethit+komand. stacionioficer1		
2. Përgjegjës shërbimipolic4		
3. Shoferë zjarrfikëspolic4		
4. Policë zjarrfikëspolic6		
	funksione	15
Totali	funksione	33

XII. PREFEKTURA E QARKUT, DIBËR

1. Shefi i sektorit të PMNZSH-së Prefektit të Qarkutoficer1		
Stacioni PMNZSH-së, Peshkopi		
2. Komand.stacioni+ kujdestarpolic1		
3. Inspektor profilaksiepolic1		
4. Përgjegjës shërbimipolic4		
5. Shoferë zjarrfikëspolic4		
6. Policë zjarrfikës, shpëtuespolic8		
funksione	18	

Stacioni i PMNZSH-së, Burrel

1. Shefi i PMNZSH-së rrethit + Komand.stacionioficer1

2. Përgjegjës shërbimipolic4

3. Shoferë zjarrfikëspolic4

4. Policë zjarrfikëspolic4

funksione 13

Stacioni i PMNZSH, Bulqizë

1. Shefi i PMNZSH rrethit + Komand.stacionioficer1

2. Përgjegjës shërbimipolic4

3. Shoferë zjarrfikëspolic4

4. Policë zjarrfikëspolic4

funksione 13

Totali

funksione 44

V E N D I M
Nr. 78, datë 6.2.2003

**PËR MIRATIMIN E STEMËS, TË UNIFORMËS DHE TË NORMATIVAVE TË
VESHMBATHJES PËR POLICINË E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 6 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e uniformës për personelin drejtues (oficer) dhe për personelin operues (polic zjarrfikës), si dhe të normave të veshmbathjes, përkatësisht, sipas lidhjeve nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e stemës së PMNZSH-së sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.2

Norma e veshmbathjes për oficerët e PMNZSH-së

Nr	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup shevro	1	4	E zezë
2	Xhup trikoton	1	3	Blu e errët
3	Kostum stof me përzierje (xhaketë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	2	Blu e errët

4	Pantallona vere	2	2	Blu e errët
5	Pulovër	1	2	Blu e errët
6	Këmishë me mëngë të gjata	2	1	E bardhë
7	Këmishë me mëngë të shkurtëra	2	1	E bardhë
8	Bluza me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
9	Bluza me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
10	Këpucë gjysma, lëkure, verore	1	1	Të zeza
11	Këpucë gjysma, lëkure, dimërore	1	1	Të zeza
12	Rrip pantallonash	1	2	I zi
13	Gravatë	2	3	Blu e errët
14	Doreza lëkure	1	4	Të zeza
15	Çorape	4	1	Të zeza
16	Këpucë me qafa	1	2	Të zeza
17	Kostum doku për stërvitje	1	5	Blu e errët
18	Rrip sigurimi	1	5	
19	Grada	2	2	Blu e errët
20	Uniformë speciale kundër zjarrit	1	Pa afat	

Lidhja nr.2

Norma e veshmbathjes për personelin operues (policë zjarrfikës)

Nr	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup trikoton	1	3	Blu e errët
	Kostum pune vere, dok trikoton (xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	1	Blu e errët
3	Kostum pune dimri, dok trikoton (xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	1	Blu e errët
4	Pantallona vere	2	2	Blu e errët
5	Pulovër	1	2	Blu e errët
6	Këmishë me mëngë të gjata (jakë sportive)	2	1	E bardhë
7	Këmishë me mëngë të shkurtëra(jakë sportive)	2	1	E bardhë
8	Bluza me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
9	Bluza me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
10	Këpucë gjysma, lëkure, verore	1	1	Të zeza
11	Këpucë gjysma, lëkurë, dimërore	1	1	Të zeza
12	Rrip pantallonash	1	2	I zi
13	Çorape	4	1	Të zeza
14	Këpucë me qafa (zjarrfikëse)	1	2	Të zeza
15	Rrip sigurimi	1	5	
16	Grada	2	2	Blu
17	Uniformë speciale kundër zjarrit	1	Pa afat	



Lidhja nr.3

Stema e vendosur ne krahun e majte.



Pjese perberse e stemes, vendosur
ne jakat e xhaketes dhe kemishes.

V E N D I M
Nr.79, datë 6.2.2003

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe niveli i pagës për punonjësit e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1 – diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.
 3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3), jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) është 0.
 5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr.1.
 6. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase të bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, e cila, bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 7. Punonjësit e tjerë, që nuk përfshihen në lidhjet nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi, paguhet sipas lidhjes II-4 “Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave”, dhe lidhjes II.M “Paga bazë, sipas klasave për punonjësit e ministrave, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe shërbimit gjeologjik shqiptar”, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet përkatëse.
 8. Niveli i pagës për emërtesën sekretar/asistent/arkëtar barazohet me nivelin e pagës së punonjësit të kategorisë III-a, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 9. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Këshillit të Ministrave.
 10. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Nivelet e pagës për punonjësit e institutit të trajnimit të administratës publike

Klasa	Paga mujore				
	Kategoritë	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e	Shtesa vjetore	Shtesa për	Shtesa për

		grupit (PG)	për vjetërsi (SHV)	kualifikim (SHK)	pozicion (SHP)
I	I-a	9.000	2%	0	90.000
II	II-a	9.000	2%	0	55.000
III	III-a	9.000	2%	0	30.000
III	III-b	9.000	2%	0	20.000

Lidhja nr.2

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS

Klasa I: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bën pjesë:

I-a Drejtori i institutit të trajnimit

Klasa II: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë:

II-aTrajnerët e përhershëm, përgjegjës finance/koordinator

Klasa III: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë:

III-aSpecialistë

III-bArkivistë

V E N D I M

Nr. 81, datë 6.2.2003

PËR SHITJE TRUALLI, KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 3 e të paragrafit të parë, të nenit 8 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë t’i shitet trualli me sipërfaqe prej 966 m2 në qytetin e Tiranës, në pjesën lindore të pronës së kësaj kishe, sipas gentplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Çmimi i shitjes së truallit të jetë 1 600 lekë/m2.

3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 84, datë 13.2.2003

**PËR ADMINISTRIMIN DHE MBULIMIN E SHËRBIMEVE NGA PERSONELI
MJEKËSOR, I PËRFSHIRË NË SKEMËN E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të gjashtë, të nenit 26 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kujdesi shëndetësor parësor jepet nga mjeku i përgjithshëm, mjeku i familjes, mjeku specialist dhe infermierët, që punojnë në shërbimin shëndetësor parësor.

2. Mjeku i përgjithshëm për të rritur, u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm të gjithë personave me moshë mbi 14 vjeç në qytet.

Mjeku i përgjithshëm për moshat 0-14 vjeç, u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm fëmijëve të kësaj moshe.

Mjeku i përgjithshëm për të gjitha moshat, në qytet, u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm banorëve të qytetit, të të gjitha moshave.

Mjeku i përgjithshëm për të gjitha moshat, në fshat, u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm banorëve të fshatit, të të gjitha moshave.

Mjek patolog është mjeku i përgjithshëm, që ka kryer specializimin e plotë pasuniversitar në specialitetin “Patologji e përgjithshme”.

Mjek pediatër është mjeku i përgjithshëm, që ka kryer specializimin e plotë pasuniversitar në specialitetin “Pediatri e përgjithshme”.

Mjek familje është mjeku i përgjithshëm, që ka kryer specializimin e plotë pasuniversitar në specialitetin “Mjek familje”.

Mjek specialist është mjeku, që ka kryer specializimin e plotë pasuniversitar në specialitetin përkatës, sipas përcaktimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Infermier është punonjësi i shërbimit shëndetësor, që ka kryer shkollën e lartë të infermierisë, shkollat e mesme mjekësore ose kurset, sipas përcaktimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

3. Kujdesi shëndetësor parësor jepet në institucionet e shërbimit shëndetësor, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Mjeku ushtron veprimtarinë në një territor të caktuar dhe mbulon një numër të caktuar personash. Norma dhe kufiri maksimal i ngarkesës për një mjek caktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

5. Organizimi i shërbimit të mjekut të përgjithshëm dhe i mjekut të familjes bazohen në parimin e zgjedhjes së lirë të mjekut nga pacienti, brenda rrethit ku banon. Në raste të veçanta, për pacientët e fshatrave në kufijtë ndërmjet dy rrethëve ose kur kushtet e terrenit e vështirësojnë marrjen e shërbimit shëndetësor nga mjeku i rrethit, pacienti mund të zgjedhë edhe mjekun e rrethit tjetër, kur ky është më i afërt me atë zonë.

6. Drejtoritë rajonale të sigurimeve të kujdesit shëndetësor në rrethe, lidhin kontrata me qendrën shëndetësore ose me individë të shërbimit shëndetësor, shtetëror ose privat.

7. Këshilli Administrativ i ISKSH-së miraton kontratat tip për mjekët dhe institucionet e këtij shërbimi shëndetësor parësor.

8. Shpërblimi i punës së personelit mjekësor të këtij shërbimi bëhet sipas kritereve, të miratuara nga Këshilli Administrativ i ISKSH-së.

9. Mjeku është i detyruar ta kryejë vizitën mjekësore edhe në rastet kur i sëmuri nuk ka paguar kontributin për sigurimin shëndetësor. Në këto raste i sëmuri paguan, sipas tarifave të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë.

10. Mjeku i përgjithshëm, mjeku i familjes dhe mjeku specialist, të cilët lidhin kontratë për dhënien e shërbimit shëndetësor parësor, emërohen nga drejtoritë rajonale të sigurimeve të kujdesit shëndetësor, me propozimin e drejtorisë së shëndetit publik të rrethit përkatës.

11. Ngarkohet ISKSH-ja të nxjerrë udhëzimet në zbatim të këtij vendimi.

12. Vendimi nr.343, datë 3.7.1995 i Këshillit të Ministrave “Për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit shëndetësor të mjekut të përgjithshëm dhe të familjes nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 85, datë 13.2.2003

PËR LIDHJEN E KONTRATAVE, NDËRMJET INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUDJESIT SHËNDETËSOR DHE FARMACIVE E DEPOVE TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për mbulimin e një pjese të çmimit të barnave, lidh kontratë me depot e barnave dhe me farmacitë e rrjetit të hapur, që shprehin interes për t’u përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore.

2. Këshilli Administrativ i ISKSH-së përcakton kriteret, që duhet të përmbushin depot e barnave dhe farmacitë e rrjetit të hapur, për të kontraktuar me këtë institut.

3. Këshilli Administrativ i ISKSH-së miraton kontratën tip për farmacitë dhe depot e barnave dhe afatet kohore të lidhjes së tyre.

4. Të gjitha farmacitë, që kanë kontratë me ISKSH-në, janë të detyruara të tregtojnë barna vetëm me recetë të mjekut, me përjashtim të barnave që tregtohen pa recetë, sipas listës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

5. Të gjitha farmacitë, që kanë kontratë me ISKSH-në, janë të detyruara të tërheqin barnat e rimbursueshme të listës, vetëm në depot e barnave që kanë kontratë me këtë Institut.

6. Depot e barnave, që kanë kontratë me ISKSH-në, duhet të zbatojnë çmimet e depoz për barnat e listës.

7. Dokumentacioni për qarkullimin e barnave nga depot të mbahet sipas formateve të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë.

8. ISKSH-ja pajis mjekët me receta me rimbursim dhe parimbursim, si dhe përcakton rregullat për administrimin e tyre.

9. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 86, datë 13.2.2003

PËR LIBREZËN E SHËNDETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e

Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Libreza e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar, sipas ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Libreza e shëndetit është personale dhe e patjetërsueshme. Përdorimi i librezës nga persona të tjerë nuk lejohet, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me udhëzimin e veçantë të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

3. Forma dhe përmbajtja e librezës së shëndetit përcaktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

4. Të siguruarit janë të detyruar të pranojnë në çdo kohë kontrollin nga specialistët e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për të gjitha shërbimet e përfituara, që mbulohen nga skema e sigurimeve shëndetësore.

5. Kontrolli i specialistëve përfshin verifikimin e librezës së shëndetit e të riekzaminimeve mjekësore, nëse është i nevojshëm.

6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor harton udhëzimin për pajisjen e të siguruarve me librezë shëndeti dhe për plotësimin e përdorimit të tyre.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 87, datë 13.2.2003

PËR IDENTIFIKIMIN DHE DETYRIMET E PERSONAVE, QË MARRIN SHËRBIM SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, të siguruar ose jo, që kërkojnë të marrin shërbim shëndetësor në institucionet shëndetësore të shërbimit parësor, në shërbimin shëndetësor dytësor, tretësor dhe në farmacitë e rrjetit të hapur, janë të detyruar të paraqesin, sipas rastit, dokumentacionin si më poshtë vijon:

- librezën e shëndetit;
- rekomandimin e mjekut të familjes;
- rekomandimin e mjekut specialist;
- mandatpagesën për vizitën ambulatorë pa rekomandim;
- mandatpagesën për vizitën te mjeku pa qenë i siguruar.

2. Të siguruar quhen personat që paguajnë kontributin e sigurimeve shëndetësore, si dhe personat për të cilët shteti paguan kontribute, sipas nenit 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Të gjithë personat, që nuk janë të siguruar sipas pikës 2 të këtij vendimi ose kur janë të siguruar, por nuk paraqesin dokumentacionin sipas pikës 1, marrin shërbim shëndetësor duke paguar tarifat e miratuara në sistemin shëndetësor ose çmimin e plotë të barnave.

4. Institucionet shëndetësore janë të detyruara të pranojnë sipas pikës 1, kontrollin e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë, që, në mbështetje të propozimit të Këshillit Administrativ të Institutit të Shërbimit Shëndetësor, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 12.3.2003
Doli nga shtypi më 13.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë